

Formati i Punimit MA

Doracak për studentë



BASHKËSIA ISLAME E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
FAKULTETI I STUDIMEVE ISLAME - PRISHTINË

Bajram Kelmendi, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: +383-38-243 887, Fax: +383-38-245 367

E-mail: fakulteti.92@gmail.com

Përmbajtja

Përmbajtja	2
INFORMATA TË PËRGJITHSHME	3
FORMATI.....	3
Struktura.....	3
Fonti dhe Margjinat.....	4
Fonti i tekstit arab	4
Numërimi	5
FAQET PARAPRAKE	5
Ballina	5
Faqja titulluese	7
Autorësia	7
Dedikimi.....	7
Falënderimi	7
Abstrakti.....	9
Parathënia.....	9
Modeli i Abstraktit.....	10
Lista e Tabelave.....	11
Lista e Figurave.....	11
Lista e Indekseve - Shkurtesave.....	11
Lista e të dhënave në CD	11
TEKSTI	14
Organizimi i tekstit në kapituj.....	14
Figurat dhe Tabelat.....	16
Shtojca.....	16
Burimet dhe Literatura	17

Informata të përgjithshme

Tema duhet të jetë punë origjinale e studentit. Studenti duhet gjithashtu të jetë autori i parë ose kontribuesi kryesor i ndonjë punimi të futur si kapitull në temë.

Rregull i përgjithshëm është se në të gjitha punimet e shkruara gjithmonë duhet të dallohet qartë teksti dhe njohuritë e huaja nga teksti i autorit, konkluzionet e tij, njohuritë, idetë, dhe të dhënat e ngjashme.

Punimi i temës shkruhet në gjuhën shqipe. Teksti i punimit duhet të jetë korrekt nga pikëpamja gramatikore dhe drejtshkrimore, si dhe pa gabime shtypi.

Tema duhet të dorëzohet në kopje të fortë dhe në kopje elektronike (në CD). Numri i kopjeve të forta përcaktohet varësisht nga numri i anëtarëve të komisionit; pra, secili anëtar i komisionit duhet ta ketë një kopje. Gjithashtu një kopje duhet të jetë për Arkivin e Fakultetit, një për Bibliotekën e Fakultetit dhe një për Bibliotekën e Kryesisë. CD-ja duhet të jetë në dy kopje: një për mentorin, dhe një për Arkivin e Fakultetit.

Përgjegjësia për gabimet e mundshme në rregullimin e formatit do të mbetet te studentit, dhe ai nuk mund të arsyetohet për problemet teknike, siç mund të jenë ato me printerin, kompjuterin apo programin që është përdorur. Në përgjegjësinë e studentit është edhe zgjedhja e pajisjes apo e shërbimit adekuat për ta rregulluar temën dhe përmbajtjen e saj në mënyrë adekuate.

Tema duhet të printohet vetëm në njërën anë të fletës, dhe duhet të shtypet me printer laser, që prodhon tekst të dendur, të qartë dhe konsistent, si dhe fotoilustrimet cilësore. Tema nuk do të pranohet nëse printimi është jocilësor, pra me pika, vija dhe pjesë të errësuara si rezultat i printimit të dobët. Tema duhet të printohet në letër cilësore.

Shërbimet administrative të Fakultetit nuk do të pranojnë tema që nuk u janë përmbajtur kushteve teknike të miratuara nga Fakulteti, e që janë të paraqitura në këtë doracak.

Formati

Struktura

Shumica e temave kanë një gjatësi nga 70 deri në 150 faqe, dhe teksti duhet të jetë i shkruar vetëm në njërën anë të letrës. Tema duhet të jetë e organizuar në tri pjesë:

- pjesën hyrëse (paraprake);
- pjesën bazë, (tekstin kryesor) dhe;
- pjesën e tretë (shtojcën dhe referencat).

Tema duhet të ndahet në kapituj, çështje dhe nënçështje.

Faqja duhet të jetë e mbushur me tekst, nga fillimi deri në fund. Përjashtime bëhen vetëm në faqen e fundit të kapitullit dhe në rastet kur një rresht i vetëm i paragrafit mbetet në fund të faqes.

Në vijim është paraqitet edhe struktura e punimit të diplomës-Masterit:

1. Faqet hyrëse (paraprake)

- Faqja e titullit
- Faqja e të drejtës së autorit
- Faqja e dedikimit (opsionale)
- Faqja e falënderimit (opsionale)
- Abstrakti
- Abstrakti (në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze)
- Parathënia (opsionale)
- Përmbajtja
- Lista e Tabelave
- Lista e Figurave
- Lista e Indekseve, Termave, Simboleve, e Fjalëve ose e Shkurtesave
- Të dhëna në Compact Disk (opsionale, me lejen e mentorit)

2. Teksti kryesor

- Studentët e përcaktojnë përmbajtjen e brendshme të tekstit në pajtim me mentorin apo komisionin përkatës. Teksti kryesor zakonisht përmban *Hyrjen, kapitujt bazë dhe Përfundimin*.

3. Seksioni i referencave

- Shtojca/t
- Referencat dhe/ose Bibliografia

Fonti dhe Margjinat

Punimi duhet të jetë i shtypur në letër A4 (210 × 297 mm). Faqja mund të ketë më së shumti 1800 –2200 shenja, dhe nuk duhet të ketë më tepër se 35 rreshta. Fonti (lloji i germave) duhet të jetë Times New Roman, dhe madhësia 12 pikë tipografike, kurse hapësira e rreshtave duhet të jetë 1.5 radhë (*1.5 line spacing*). Madhësia minimale në fusnota, indekse apo simbole duhet të jetë 10 pikë tipografike.

Fonti i tekstit arab

Shkrimi i teksteve arabe duhet të jetë:

Ajetet kuranore me llojin e shkronjave Tradicional arabic – bold, madhësia 16-18

Kurse hadithet me llojin e shkronjave Tradicional arabic – normal (jo bold) 16-18

Margjinat definoohen si hapësira të ZBRAZËTA që e rrethojnë tekstin. Asgjë, duke përfshirë edhe numrin e faqeve, nuk mund të paraqitet në hapësirën e margjinave. Dimensionet e margjinave janë: ana e majtë duhet të jetë 3 cm, pasi kjo është ana që duhet lidhur, kurse të tri anët e tjera: pra, lart, poshtë dhe ana e djathtë, duhet të kenë margjina 2.5 cm. Çdo tabelë, figure, grafik apo diagram e paraqitur në temë apo disertacion duhet të përshtatet brenda hapësirës së kufizuar me margjina. Lidhur me këtë kriter nuk mund të ketë asnjë përjashtim.

Numërimi

Secila faqe e punimit të diplomës-Masterit duhet ta ketë një numër. Për faqet paraprake përdoren numrat romakë (I, II, III, IV, V...). Ata mund të vendosen në pjesën e poshtme të faqes. Duhet llogaritur faqja titulluese si faqe numër I, versioni anglisht si faqe II, dhe faqja e autorësisë si faqe III, *mirëpo mos të vendoset numri i faqes në asnjërën faqe.*

Për tekst të përdoren numrat arabë (1, 2, 3, 4, 5...), duke filluar me faqen 1 (në faqen e parë të vetë tekstit). Numrat duhet të jenë në qendër, në pjesën e poshtme të faqes. Pavarësisht nga ndryshimet numri i faqes duhet të jetë konsistent në tërë punimin. Numri duhet të jetë i larguar për 2 cm nga skaji i faqes, me qëllim që të shmanget humbja kur të lidhet punimi.

Faqet paraprake

Ballina

Fonti i shkronjave duhet të jetë 14. Titulli, emri i autorit, emri i Bashkësisë Islame të Kosovës dhe emri i fakultetit të jenë me shkronja të mëdha.

Titulli duhet të jetë sa më kuptimplotë dhe sa më i përputhshëm me përmbajtjen e temës. Studentët inkurajohen fuqishëm që t'i përfshijnë fjalët çelës në titull, pasi ashtu titulli mund të gjendet më lehtë gjatë kërkimeve kompjuterike, sikurse, për shembull, në Google ose në platforma të tjera elektronike.

Titulli nuk duhet të ketë më shumë se 200 shkronja dhe hapësira në total.

Ballina duhet të përmbajë titullin e punimit, gradën shkencore që arrihet me atë punim, emrin e autorit, logon e fakultetit, emrin e BIRK-ut, emrin e fakultetit, muajin dhe vitin e publikimit. Drejtimi mund të jetë opsional. Logo e Fakultetit duhet të ketë dimensione 4x 4 cm.

Në pjesën anësore të temës rekomandohet të shkruhet emri i autorit dhe viti i publikimit (në mes).

Më poshtë paraqitet një shembull si ilustrim i asaj, që u tha më lart.

Vërejtje: Faqja e ballinës duhet të jetë vetëm në kopertinë të temës, dhe jo në faqen e parë të temës. Pra, faqja e parë duhet të fillojë me faqen titulluese, faqen e autorësisë, e kështu me radhë.

Modeli i Ballinës.

[*Titulli i Punimit*]

TEMA PËR TITULLIN

MASTER I ARTEVE NË [*emri zyrtar i drejtimit në të cilin
është fituar titulli*]

nga

[*emri dhe mbiemri i autorit*]



BASHKËSIA ISLAME E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
FAKULTETI I STUDIMEVE ISLAME
Prishtinë

[*MUAJI DHE VITI I KOMPLETIMIT TË TEMËS*]

Faqja titulluese

Faqja titulluese është faqja e parë e punimit. Kjo faqe nuk dallon shumë nga faqja e ballinës. Shkrimi duhet të jetë i madhësisë 12. Titulli, emri i autorit dhe emri i fakultetit të jenë me shkronja të mëdha. Logo të ketë dimensionet 3x3 cm.

(Shiko faqen pasardhëse për shembullin e faqes titulluese!).

Pas faqes titulluese vijon faqja e njëjtë, në gjuhën angleze.

Autorësia

Faqja e dytë duhet të përmbajë autorësinë. Teksti duhet të jetë i vendosur në qendër, vertikalisht dhe horizontalisht. Faqja nuk duhet të përmbajë asnjë tekst tjetër përveç atij të shkruar si në vijim:

© [viti] - [emri i autorit]

Të gjitha të drejtat të rezervuara!

Duhet të sqarohet një qasje e gabuar lidhur me autorësinë: përdorimi i informatave të botuara, edhe nëse i jepet vlerësim i plotë autorit të materialit të huazuar; pra, nëse puna citohet në punim, nuk nënkupton se e liron autorin nga obligimet që dalin nga ligji për të drejtat autoriale. Përdorimi i drejt i një fusnote nuk është i mjaftueshëm për t'u liruar nga përgjegjësia.

Dedikimi

Dedikimi është opsional. Nëse shkruhet, duhet përdorur shkrim 1.5 radhë, dhe të jetë i vendosur vertikalisht dhe horizontalisht. Të ketë madhësi të shkronjave 12, dhe të jetë në shkrim të pjerrët (*Italic*). Dedikimi është personal, dhe është i domosdoshme të shkruhet në gjuhën në të cilën është shkruar tema.

Falënderimi

Falënderimi është opsional. Teza apo disertacioni është një dokument formal (zyrtar), dhe falënderimi duhet ta reflektojë të njëjtën shkallë të profesionalizmit. Nëse futet në temë, duhet të jetë një shkrim konciz, dhe mos të jetë më i gjatë se (1/3 apo 2/3 e faqes). Vetëm personat e përmendur në vazhdim mund të

falënderohen: mentori i temës; anëtarët e komisionit të tezës master;

studentët kolegë, të cilët kanë dhënë kontribut teknik në temë; përkrahësit financiarë; pronarët e të drejtës së autorit (copyright), të cilët

kanë dhënë leje për shfrytëzimin (riprintimin) e materialeve me të drejtë të rezervuar, si dhe anëtarët e familjes.

Modeli i Faqes Titulluese.

[Titulli i Punimit]

Tema e prezantuar

prej

[emri dhe mbiemri i autorit]

pranë

[emri zyrtar i departamentit, apo institutit]

në plotësimin e pjesshëm të obligimeve për ta fituar titullin
Master i Arteve në [emri zyrtar i drejtimin në të cilin është fituar titulli]

[Muaji dhe viti i kompletimit të temës]



BASHKËSIA ISLAME E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
FAKULTETI I STUDIMEVE ISLAME
PRISHTINË

Aprovuar nga:

Emri Mbiemri, Titulli, Mentor

Data

Emri Mbiemri, Titulli, Anëtar

Data

Emri Mbiemri, Titulli, Anëtar

Data

Abstrakti

Të gjitha disertacionet duhet ta përmbajnë një abstrakt. Një abstrakt i tezës së Masterit nuk mund të jetë më i gjatë se 150 fjalë; abstrakti duhet të ketë (1) shtjellimin e problemit, (2) një paraqitje të metodave dhe procedurave të hulumtimit dhe (3) një përmbyllje të rezultateve të përftuara. Nëse abstrakti duhet të vazhdojë në faqen tjetër, titulli, etj., nuk duhet të përsëritet.

Abstrakti shkruhet në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze

Në fund të secilit version të abstraktit shënohen Fjalët kyçe.

Parathënia

Parathënia nuk duhet të përmbajë ndonjë material të mbuluar diku tjetër në punim, në abstrakt, hyrje apo në përmbyllje dhe përfundim. Nëse përdoret, duhet të përmbajë një përshkrim të shkurtër për përmbajtjen apo qëllimin e shkruarjes së punimit. Gjithashtu mund të sqarohet arsyeja e autorit për përzgjedhjen e temës dhe mendim (besimi) i tij/i saj lidhur me rëndësinë e punimit. Nëse janë përdorur artikuj të publikuar si seksione apo kapituj në temë, parathënia duhet ta përmbajë emrin e revistës në të cilën është pranuar punimi për publikim. Te parathënia titulli shkruhet me shkronja të mëdha (PARATHËNIA), lihen tri hapësira “single spaces”, dhe vazhdohet teksti me 1.5 radhë.

Përmbajtja

Te përmbajtja titulli shkruhet me shkronja të mëdha (PËRMBAJTJA), pastaj lihen tri hapësira “single spaces”, dhe vazhdon teksti me titujt dhe nëntitujt. Hapësira e rreshtave në tekst duhet të jetë 1.5, mirëpo për tituj të gjatë që vazhdojnë në rreshtin tjetër aplikohet “single space” për hapësirën mes rreshtave. Në mes të tekstit dhe të numrave duhet të ketë një zbrazëti 2.5 cm. Kur përmbajtja kalon në faqen tjetër, duhet të veprohet si në faqen e parë, duke shënuar në kreun e faqes (PËRMBAJTJA – Vazhdim) dhe të lihen tri hapësira “single spaces” para se të vazhdohet me tekstin me titujt; shih figurën 1 a. Shembulli i faqes së përmbajtjes tregohet në Figurën 1 a dhe 1 b.

Lista e Tabelave

Rregullimi i listës së tabelave është i ngjashëm me atë të përmbajtjes. Pra, shënohet titulli “Lista e Tabelave”, lihen tri hapësira “single spaces”, dhe vazhdohet me numrin e tabelës, lihet një hapësirë dhe shënohet përshkrimi i tabelës, dhe pastaj numri i faqes ku ndodhet tabela. Në mes të tekstit të tabelës dhe numrave të faqes duhet të lihet një hapësirë e zbrazët 2.5 cm.

(Shiko shembullin e faqes së Listës së Tabelave, figura 2!)

Lista e Figurave

Rregullimi i listës së figurave është i ngjashëm me atë të përmbajtjes. Pra, shënohet titulli “Lista e Figurave”, lihen tri hapësira “single spaces”, dhe vazhdohet me numrin e figurës, lihet një hapësirë dhe shënohet përshkrimi i figurës, dhe pastaj vjen numri i faqes ku ndodhet figura. Në mes të tekstit të figurës dhe numrave të faqes duhet të lihet një hapësirë e zbrazët 2.5 cm.

(Shiko shembullin e faqes së “Listës së Figurave”, figura 3!).

Lista e Indekseve - Shkurtesave

Rregullimi i listës së indeksve është i ngjashëm me atë të përmbajtjes. Pra, shënohet titulli “Lista e Indekseve”, lihen tri hapësira “single spaces”, dhe vazhdohet me simbolin e indeksit, lihet një hapësirë dhe shënohet përshkrimi i indeksit. Lista e indeksve nuk ka numër të faqes se ku ndodhet indeksi.

Lista e të dhënave në CD

Rregullimi i listës së të dhënave në CD është i ngjashëm me atë të përmbajtjes. Pra, shënohet titulli “Lista e Indekseve”, lihen tri hapësira “single spaces”, dhe vazhdohet me numrin rendor të të dhënave, lihet një hapësirë dhe shënohet përshkrimi i të dhënave në CD.

Të dhënat e përshtatshme për t’u përfshirë në CD do të përmbajnë, mirëpo nuk janë të kufizuara domosdo në artikuj të kalkulimeve të gjata në kompjuter, të dhëna në tabela, harta kolor, e që nuk mund të konvertohen në bardh e zi, diagrame komplekse dhe source code. Artikujt në CD nuk do të paraqiten në listën e tabelave apo të figurave. Këto materiale duhet të jenë pjesë përbërëse të tezës/disertacionit, dhe duhet të jenë material që nuk mund të përfshihen në mënyrë të përshtatshme në kopje në letër. Një CD mund t’i bashkëngjitet një teze vetëm me aprovimin e mentorit.

PËRMBAJTJA

Single spacing		FALËNDERIMI	iv
		ABSTRAKTI	vi
		LISTA E TABELAVE	vii
		LISTA E FIGURAVE	viii
		KAPITULLI I	1
		HYRJA	
		KAPITULLI 2	
		INFORMATAT E PËRGJITHSHME LIDHUR ME FORMËN	
		KAPITULLIT	3
		2.1. Titulli i nivelit të parë pas titullit të kapitullit	10
		2.1.1. Titull i nivelit të dytë pas titullit të kapitullit	10
		2.1.2. Titulli i nivelit të dytë pas titullit të kapitullit	13
		2.1.3. Titulli i nivelit të dytë pas titullit të kapitullit	15
		2.2. Titulli i nivelit të dytë. Kur titulli është më i gjatë se një rresht në gjatësi, vendos single space në stest dhe double space në mes titujve. Radhite numrin me rreshtin e fundit.	21

Numrat e faqeve janë të drejtuar me

lejo 2.5 cm hapsirë në mes të titujve dhe numrit të faqeve

a)

Single spacing		PËRMBAJTJA – Vazhdim	
		3.4. Nivel i parë i titullit	
		3.5. Nivel i parë i titullit në kapitull	114
		KAPITULLI 4	
		TEKSTI I TITULLIT TË KAPITULLIT TË KATËRT SI MODEL SI	
		DUHET TË SHKRUHET TITULLI	120
		4.1. Nivel i parë i titullit me kapitullin e katërt	122
		4.2. Nivel i parë i titullit	126

Vendose këtë titull kur Përmbajtja vazhdon në faqën tjetër.

b)

Figura 1 Shembull i përmbajtjes së dokumentit. a) faqja e parë, b) faqja vazhduese. (Shembulli është foto, dhe nuk prezanton dimensionet reale)

LISTA E TABELAVE

<div style="border: 1px solid black; padding: 2px; display: inline-block; color: red;">3 Single spacing</div>			
		Lejo 2.5 cm hapësirë në mes titullit dhe numrit,të faqes.	
			8
Tabela 2.1	Shtype titullin e kompletuar të Tabelës 2.1.		8
Tabela 2.2	Shtype titullin e kompletuar të Tabelës 2.2.		10
Tabela 2.3	Shtype titullin e kompletuar të Tabelës 2.3.		17
Tabela 3.1	Shtype titullin e kompletuar të Tabelës 3.1. Kur një titull është më i gjatë se një rresht, përdor single space në titull dhe double space në mes titujve. Radhite numrin e faqes me rreshtin e fundit		33
Tabela XX	Shtype titullin e kompletuar të Tabelës XX		99
Tabela XX	Shtype titullin e kompletuar të Tabelës XX		105

Figura 2 Shembull i përmbajtjes së tabelave. (Shembulli është foto, dhe nuk prezanton dimensionet reale)

LISTA E FIGURAVE

<div style="border: 1px solid black; padding: 2px; display: inline-block; color: red;">Single spacing</div>			
		Lejo 2.5 hapësirë në mes titullit dhe numrit të faqes.	
			8
Figura 2.1	Shkruaje fjalinë e parë të tekstit të figurës ashtu siç paraqitet në manuskript		8
Figura 2.2	Shkruaje fjalinë e parë të tekstit të figurës ashtu siç paraqitet në manuskript		10
Figura 2.3	Shkruaje fjalinë e parë të tekstit të figurës ashtu siç paraqitet në manuskript		17
Figura 3.1	Shkruaje fjalinë e parë të tekstit të figurës ashtu siç paraqitet në manuskript. Kur një titull është më i gjatë se një rresht, përdor single space në titull dhe double space në mes titujve. Radhite numrin e faqes e fundit.		33
Figura XX	Shkruaje fjalinë e parë të tekstit të figurës ashtu siç paraqitet në manuskript		100

Figura 3 Shembull i përmbajtjes së figurave. (Shembulli është foto, dhe nuk prezanton dimensionet reale)

Teksti

Organizimi i tekstit në kapituj

Tema duhet të organizohet në kapituj. Duhet ta ketë Hyrjen, kapitujt bazë (3-5) dhe Përfundimin. Kapitujt bazë zakonisht përmbajnë Hulumtimin e Literaturës, Procedurën e Hulumtimit dhe Rezultatet. Përmbajtja e temës do të caktohet prej studentit, në bashkëpunim me mentorin dhe anëtarët e komisionit. Organizimi i tekstit të kapitullit, si dhe titujve dhe nëntitujt në kapitull, duhet të rregullohen në mënyrë standarde për të gjithë kapitujt.

Në faqen, ku fillon kapitulli së pari lihen tri zbrazëtira “single spaces”, dhe pastaj shkruhet teksti KAPITULLI dhe numri i kapitullit. Numri i kapitullit mund të jetë me fjalë ose me numra. Lihet një hapësirë “single space”, dhe shënohet titulli i kapitullit. Lihen prapë tri zbrazëtira “single spaces”, dhe pastaj fillohet me tekstin, apo titullin e nivelit të parë. Teksti i kapitullit dhe titullit të kapitullit shkruhet me shkronja të mëdha. Teksti i titullit mund të jetë bold (*shkrim i trashuar*), ose i nënvizuar. Teksti duhet të jetë i rreshtuar (Aligned) vetëm në anën e majtë (kjo bëhet në kompjuter, me komandën *Ctrl+L*).

Në temë mos të ketë më shumë se katër nivele të nëntitujve. Nëntitujt mund të jenë të rregulluar me numra, apo edhe pa numra. Titulli i nivelit të parë vendoset në mes. Titulli i nivelit të dytë vendoset në anën e majtë. Titulli i nivelit të tretë vendoset në anën e majtë, mirëpo është i zhvendosur për një hapësirë (Tab) nga e djathta. Titulli i nivelit të katërt është i ngjashëm me atë të nivelit të tretë, mirëpo teksti vazhdon menjëherë pas titullit; pra, titulli është pjesë e paragrafit. Të dhëna më të detajuara janë dhënë në shembullin e faqes titulluese të kapitullit.

Titujt nuk mund të paraqiten si rreshta të fundit në një faqe. Ata duhet të jenë të shoqëruar nga së paku tre rreshta të tekstit. Nëse një titull mbetet në fund të faqes, ai duhet të zhvendoset në faqen tjetër. Kur një titull ndodhet në kreun e faqes, nuk duhet të lihet hapësirë në mes të margjinës së sipërme dhe titullit; pra, titulli duhet të fillojë në kreun e faqes. Gjithashtu, nuk duhet të ketë hapësirë në mes të margjinës së sipërme dhe tekstit të faqes.

Nëse rreshti i parë i një paragrafi paraqitet në fund të faqes, duhet të zhvendoset në faqen në vazhdim. Gjithashtu, nëse një pjesë e rreshtit të fundit të një paragrafi paraqitet në kreun e një faqeje, duhet që një rresht i faqes së mësipërme të zhvendoset te kreu i faqes në vazhdim, në mënyrë që aty të paraqiten dy rreshta në krye të faqes tjetër, para se të fillojë paragrafi i ri.

Figurat dhe Tabelat

Të gjitha figurat (grafikët, fotografitë, hartat, vizatimet, skemat, diagramet, histogramet etj.) dhe tabelat duhet të kenë emërtime dhe numër rendor. Numrat dhe emërtimet e figurave duhet të vendosen nën figurë, kurse numrat dhe emërtimet e tabelave duhet të vendosen mbi tabelë.

Figura apo tabela nuk kanë kuptim në një dokument (temë Masteri), nëse ato nuk përdoren si referime gjatë përshkrimeve të ngjarjeve apo fenomeneve të caktuara. Figura apo tabela duhet patjetër të përmenden në tekst paraprakisht. Pra, figura apo tabela duhet të jetë përmendur patjetër në tekstin para saj. Preferohet që figura mos të jetë shumë larg nga teksti ku është përmendur; pra, në të njëjtën faqe apo një apo dy faqe më poshtë.

Nuk lejohet që figura apo tabela të jetë në mes të tekstit. Nëse është më e vogël se gjysma e faqes, ajo duhet të jetë në pjesën e sipërme, apo pjesën e poshtme të faqes.

Nëse figura vendoset në pjesën e sipërme të faqes, nën figurë duhet të lihet një hapësirë “single space”, e pastaj të shkruhet përshkrimi i figurës, të lihen dy hapësira “1.5 space” (të ngjashme me tekstin), dhe të vazhdohet me tekstin, figura 4 a. Nëse figura vendoset në pjesën e poshtme të faqes, në mes të figurës dhe tekstit lihen dy hapësira “1.5 space”, e pastaj nën figurë lihet një hapësirë “single space”, dhe pastaj shkruhet përshkrimi i figurës. Përshkrimi i figurës duhet të jetë te margjina e poshtme e faqes; nuk preferohet të lihet hapësirë në mes të margjinës dhe tekstit të figurës, figura 4 b. Nëse vendosen dy figura në një faqe, në mes të figurave duhet të lihen dy hapësira “1.5 space”.

Nëse figura është më e madhe se gjysma e faqes, ajo duhet të jetë e vetmuar në faqe, duke e rregulluar ashtu që ta mbulojë tërë faqen. Pjesa e sipërme e figurës duhet të jetë nga ana e margjinës së majtë.

Edhe rregullimi i tabelave bëhet ngjashëm sikurse figurat, me përjashtim që përshkrimi i tabelës është në krye të tabelës. Në rastin kur tabela është më e madhe se gjysma e faqes, ajo nuk ka nevojë të rrotullohet sikurse figura.

Nëse figura është me ngjyra, rekomandohet që në fund të tekstit të përshkrimit të figurës të shtohet në kllapa teksti:

(Kjo figurë është prezantuar me ngjyra, printimi bardh dhe zi mundet që mos ta pasqyrojë qartë përmbajtjen e saj)

Në rast se ilustrimi nuk është kontribut origjinal i autorit të punimit, është e obligueshme të shkruhet burimi (nëse ilustrimi është i botuar), gjegjësisht autori (nëse ilustrimi nuk është i publikuar). Burimi shënohet nën ilustrim. Nëse ilustrimi është riprodhim i një veprë artistike, shënohet autori (nëse është i njohur), emërtimi, si dhe të dhënat e tjera relevante të veprës.

Shtojca

Në rastin kur tema përmban shtojcë, në një faqe duhet të përqendrohet numri dhe titulli i shtojcës, me shkronja të mëdha e vertikalisht dhe horizontalisht. Nëse është vetëm një shtojcë e bashkëngjitur në temë apo disertacion, ajo do të emërohet SHTOJCA pa “A”. Nëse ka më shumë, ato emërohen SHTOJCA A, SHTOJCA B, dhe kështu me radhë. Materiali i riprodhuar në shtojcë duhet të përshtatet brenda margjinave.

Burimet dhe Literatura

Te përshkrimi i burimeve dhe i literaturës fillimisht lihen tri hapësira “single spaces”, pastaj shënohet titulli BURIMET DHE LITERATURA, e pastaj prapë lihen dy “single spaces”, dhe tutje vazhdohet me literaturën. Literatura shkruhet e tëra me “single space”. Në mes të dy citimeve duhet të lihet një hapësirë “single space”.

Stili i literaturës dhe i citimeve varet nga fakulteti dhe drejtimi. Për shembull: stili Harvard, stili i Oxfordit, stili i Çikagos etj., preferohen në shkencat shoqërore, kurse në drejtimet e shkencave të natyrës dhe ato teknike përdoren stile të tjera, varësisht nga disiplina. FSI është përcaktuar për stilin e Çikagos, dhe në vijim janë shembujt e citimeve.

Stili i citimeve në “footnote” apo “endnote” sipas modelit të Universitetit të Çikagos

Librat me një autor	Emri dhe mbiemri i autorit (inicialet e emrit të dytë, nëse ka), ndjekur nga një presje + titulli i librit i pjerrët - italic (numri i vëllimit, nëse ka, i shënuar me numra romakë), ndjekur nga një presje + vendi + emri i botuesit + kolana, nëse ka, + viti i botimit + numri i faqeve të tekstit që i referohesh, ndjekur nga një pikë. Shembull i fusnotës: 1. Esat Stavileci, <i>Të Menduarit dhe të Shkruarit Juridik</i> , (Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës, 2013), f. 57. 2. Muhammed Ismail El Buhari, <i>Sahih El Buhari</i> . (Kajro: Taaseel Publishing, 2018), f. 219.
Librat (me dy apo më shumë autorë)	Emri dhe mbiemri i autorit të parë (inicialet e emrit të dytë, nëse ka); Emri dhe mbiemri i autorit të dytë (inicialet e emrit të dytë, nëse ka), ndjekur nga një presje + titulli i librit i pjerrët - italic (numri i vëllimit, nëse ka, i shënuar me numra romakë), ndjekur nga një presje + vendi + emri i botuesit + kolana, nëse ka, + viti i botimit + numri i faqeve, ndjekur nga një pikë. Shembull i fusnotës: 1. Peter Gourevitch and James Shinn, <i>Political Power and Corporate Control: The New Global Politics of Corporate Governance</i> (New Jersey: Princeton University Press, 2005), f. 213.
Referencat në revista-zhurnalë	Gazetat dhe Revistat Mbiemri, emri. (Titulli i artikullit) emri i gazetës, muaji dhe data, viti, seksioni/pjesa. Shembull i fusnotës: 1. Mahmud, Mustafa, (Udhëheqësit e vegjël janë lodra të të mëdhenjve), <i>Dituria Islame</i> , Qershor, 2022, f. 45, Kultura. - E nëse dihet linku i revistës dhe i shkrimit online, ai shkruhet kështu: 1. Mahmud, Mustafa, (Udhëheqësit e vegjël janë lodra të të mëdhenjve), <i>Dituria Islame</i> , Qershor, 2022, f. 45, Kultura. Dituria islame nr 379-380 – Dituria Islame (parë për herë të fundit më 13/08/2022).
Artikujt online	Mbiemri/at i/e autorit/ëve, Emri. “Titulli i artikullit të shkruar.” Titulli i zhurnalit akademik, gazetës ose revistës, vëllimi, numri i botimit (viti): faqet. Parë për herë të fundit më: data, muaji, viti. doi ose url: Shembull i fusnotës: 1. Schneider, Keith. “Salt Lake City is Finding a Payoff in Conservation.” <i>New York Times</i> , November 7, 2007. http://www.nytimes.com/2007/11/07/business/businessspecial3/07cities.html (parë për herë të fundit më 10/04/2007).
Versetet kuranore, dhe hadithet pejgamberike	-Verseti kuranor futet në thonjëza, pasohet me presje dhe shkruhet emri i kaptinës dhe numri i versetit. Shembull: “ <i>Pasha kohën! (1) Nuk ka dyshim se njeriu është në një humbje të sigurt...</i> ”, El Asr, 1-2. - <i>Citimi i hadithit po ashtu futet brenda thonjzave, dhe pasohet me emrin e koleksionuesit-autorit të librit dhe numrin e hadithit. Ndërsa, poshtë në fusnotë shkruhen detajet e referencës, sikurse në sqarimin e parë</i> Shembull: Ibën Umeri transmeton se i Dërguari i Allahut, s.a.v.s., ka thënë: “ <i>Le të mbetet namazi i vitrit ai i fundit i juaji që falni natën!</i> ”. (Buhariu, 998).

Stili i citimeve ne bibliografi sipas modelit te Universitetit te Chicagos

Referencat nga librat	<p>Mbiemri, emri i autorit, viti i botimit në kllapa + titulli i librit i pjerrët - italic (numri i vëllimit, nëse ka, i shënuar me numra romakë), ndjekur nga një presje + vendi + emri i botuesit + kolana, nëse ka, + viti i botimit + numri i faqeve të tekstit që i referohesh, ndjekur nga një pikë.</p> <p>Shembulli:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Stavileci, Esat. (2013) <i>Të menduarit dhe të shkruarit juridik</i>, Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës. 2. El Buhari, Muhammed Ismail (2018) <i>Sahih El Buhari</i>. Kajro: Taaseel Publishing.
Referencat nga revistat dhe zhurnalet	<p>Gazetat dhe revistat: Mbiemri, emri. (Titulli i artikullit), emri i gazetës, muaji, data, viti, seksioni/pjesa.</p> <p>Shembulli:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Mahmud, Mustafa. (2022) (Udhëheqësit e vegjël janë lodra të të mëdhenjve), <i>Dituria Islame</i>, Qershor, 45, Kultura. <p>-E nëse dihet linku i revistës dhe i shkrimit online, ai shkruhet kështu:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Mahmud, Mustafa. (2022) (Udhëheqësit e vegjël janë lodra të të mëdhenjve), <i>Dituria Islame</i>, Qershor, 45, Kultura. Dituria islame nr 379-380 – Dituria Islame (parë për herë të fundit më 13/08/2022).

Alfabeti i gjuhës arabe me transkriptim					
	1.	2.	3	4	Vërejtje
1.	ا	ä	a, e	1	
2.	ب	b	b	2	
3.	ت	t	t	400	
4.	ث	th	th	500	
5.	ج	xh	xh	3	
6.	ح	ḥ	h	8	Me një pikë poshtë
7.	خ	ḥ	h	600	Me një pikë lartë
8.	د	d	d	4	
9.	ذ	dh	dh	700	
10.	ر	r	r	200	
11.	ز	z	z	7	
12.	س	s	s	60	
13.	ش	sh	sh	300	
14.	ص	ṣ	s	90	Me një pikë poshtë
15.	ض	ḍ	d	800	Me një pikë poshtë
16.	ط	ṭ	t	9	Me një pikë poshtë
17.	ظ	ẓ	z	900	Me një pikë poshtë
18.	ع	'a	a	70	Me apostrof përpara
19.	غ	ġ	g	1000	Me pikë lartë
20.	ف	f	f	80	
21.	ق	q	k	100	Me pikë poshtë
22.	ك	k	k	20	
23.	ل	l	l	30	
24.	م	m	m	40	
25.	ن	n	n	50	
26.	ه	h	h	6	
27.	و	v	v	5	
28.	ي	j	j	10	

1. Alfabeti arab
2. Transkriptimi shkencor (duke përdur simbolet me fontin arial)
3. Transkriptimi i lirë
4. Vlera numerike e shkronjave arabe

Shkrimi i teksteve arabe duhet të jetë:

Ajetet kuranore me llojin e shkronjave Tradicional arabic – bold, madhësia 16-18

Kurse hadithet me llojin e shkronjave Tradicional arabic – normal (jo bold) 16-18